



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 213, datë 17.10.2019**

**PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË  
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË  
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatën në nevojë si vijon:

**GJYKATA E LARTË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}si dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues:{...}; me objekt:“Miratimin e ekstradimit në zbatim të vendimit të caktuar Gjykatës Themelore.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues:{...}; me objekt: “Lejimin e ekstradimit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë të shtetasit shqiptar Elis Coku”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, si dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së

Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues: {...}; me objekt: “Ekstradimin nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Hungarisë të shtetasit {...}”.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, si dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues: {...}; me objekt: “Ekstradimin nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë të shtetasit shqiptar {...} lidhur me vendimin e dënimit prej 16 vitesh burgim dhënë ndaj tij nga Gjykata e Apelit Bari, Itali dhe pezullimin e ekzekutimit të ekstradimit të këtij shtetasi deri në përfundimin e vuajtjes së dënimit të dhënë për të nga gjykata shqiptare”.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, si dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues: {...}; me objekt: “Miratimin e ekstradimit të shtetasit shqiptar {...} për llogari të drejtësisë italiane në zbatim të vendimit nr.4526/2015, datë 30.09.2015 të Gjykatës së Apelit.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR  
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**